


E DREJTA PËR INFORMIM



Takimi i 7-të i Komitetit Ekzekutiv të ICIC.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në cilësinë e anëtares së Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC), mori pjesë në mbledhjen e 7-të të forumit drejtues të kësaj organizate.

Pjesë e agjendës së takimit ishte informimi mbi pjesëmarrjen Zyrës së Komisionerit, si përfaqësuese e ICIC, në aktivitetin e organizuar nga Këshilli i Evropës në kuadër të Konferencës për të Drejtat e Njeriut të Varshavës. Në këtë aktivitet u prezantua roli dhe objektivat e organizatës për promovimin e të drejtës për informim dhe transparencën e autoriteteve publike kudo në botë. Komiteti Ekzekutiv u njoh edhe me iniciativat e zhvilluara për 28 Shtatorin – Ditën Ndërkombëtare të Aksesit Universal në Informacion (IDUAI), si dhe u paraqitën rezultatet e pyetësorit të vlerësimit të Konferencës së mëparshme të ICIC.

Më herët, u mbajt edhe mbledhja e parë e Komitetit të Planifikimit të edicionit të 15-të të Konferencës, e cila do të organizohet nga Zyra e Komisionerit në vitin 2024, ku u paraqit një informacion përmbledhës për ecurinë dhe

masat për zhvillimin e këtij aktiviteti të rëndësishëm. Ky grup ndërkombëtar pune, i përbërë nga ekspertë të fushës së të drejtës për informimit, ka si objektiv përgatitjen e programit të Konferencës, si edhe do të mbështesë autoritetin shqiptar në aspekte të ndryshme organizative të saj.

Vendimmarrja e Zyrës së Komisionerit

Vendim Nr. 45 - Federata Shqiptare Taekwondo World

Vendim Nr. 46 - Ministria e Kulturës

Vendim Nr. 47 - Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Vendim Nr. 48 - Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural

Vendim Nr. 49 - Antea Cement

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit tetor 2023.



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit tetor 2023, ka dhënë 5 vendime në zbatim të ligjit 119/2014 për të drejtën e informimit.

Me vendimin nr. 45, datë 06.10.2023, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj Autoritetit Publik "Federata Shqiptare Taekwondo World", për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesave për informacion konkretisht: ("Zbardhjen e të gjitha vendimeve të marra nga të gjithë komisionet e Federatës (komisioni ekzekutiv, komisioni teknik, komisioni disiplinës etj) për Shoqatën Rinore Sportive "Studenti" dhe anëtarët e saj, së bashku me dokumentacionet se ku janë mbështetur vendimet").

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit sipas kërkesave për informacion.

Zyra e Komisionerit ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesat për informacion si dhe sqarime për zotërimin e informacionit/dokumentacionit të kërkuar, duke vlerësuar në këtë mënyrë kërkesat për informacion.

Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: "vendimet e marra nga Këshilli Drejtues i Federatës Shqiptare Taekwondo World i janë nisur Shoqatës Rinore Sportive "Studenti" në email të përbashkët me të gjitha shoqatat anëtare të FSHTW në datë 02.06.2023. Më pas është kërkuar kopje e këtyre vendimeve dhe në datë 18.07.2023 i janë nisur në email kopjet e skanuara të vendimeve të marra nga organet kolegjiale të FSHTW ndaj trajnerit z. Juljan Caca. Sjellim në vëmendjen tuaj se FSHTW ka formën juridike të organizatës jofitimprurëse dhe i nënshtrohet ligjit në fuqi për organizatat jofitimprurëse në Shqipëri dhe procedurave të përcaktuara në të për funksionimin e saj dhe gjithashtu bazon aktivitetin dhe veprimtarinë e saj në Statutin dhe Rregulloren e saj të Brendshme. Ankuesi mund t'i ishte drejtuar fillimisht Federatës sipas procedurave në Rregulloren tonë të Brendshme për ankimim vendimesh (gjë e cila nuk ka ndodhur) dhe pastaj Gjykatës së Rrethit Gjyqësor duke patur parasysh ligjin për OJF-të në Republikën e Shqipërisë, mbi bazën e së cilit Shoqatat marrin statusin juridik si edhe veprojnë e operojnë juridikisht dhe financiarisht."

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi me pretendimin se, nuk i është vënë në dispozicion informacioni i kërkuar, ka vijuar ankimin duke specifikuar konkretisht objektin e kërimit si vijon: "Lënda e vendimeve të dërguara i referohet vetëm vërejtjeve të marra ndaj Trajnerit të shoqatës. Ndërkohë ne kërkojmë të zbardhen vendime të cilat kanë pjesë të tyre dhe sportistët e shoqatës, sic është: 1-vendimet e datës 25.05.2023 të komisionit drejtues 2- Vendimet e komisionit teknik mbi sportistët të cilët do të përfaqësojnë ekipin kombëtar në aktivitetet: Kampionati Botëror Senior, Multi European Games, Kampionati European Junior, kriteret ku kanë bazuar përzgjedhjen. 3-Vendimi i komisionit teknik dhe drejtues për pajisjen me breza dhe certifikata të sportistëve që testohen për brezin e kuq.

4-Vendimi i komisionit drejtues për rimbursimin e tarifës së pjesëmarrjes në kampionatin President Cup Albania 2022.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore.

Seanca u zhvillua me prezencën e ankuesit dhe përfaqësuesit të Autoritetit Publik. Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë. Ndërsa përfaqësuesi i Autoritetit Publik ngriti pretendimin se FSHTW nuk legjitimohet në këtë procedurë administrative me arsyetimin se, kjo e fundit gëzon statusin juridik të organizatës jofitimprurëse. Në përfundim të seancës dëgjimore, Komisioneri i kërkoi përfaqësuesit të Autoritetit Publik të paraqesë në formë shkresore përmbledhjen përfundimtare të qëndrimit të tij.

Autoriteti Publik rikonfirmoi qëndrimin e mbajtur në seancë dëgjimore, si edhe aktet shkresore të sipërcituara, duke pretenduar ndër të tjera se: "...Komisioneri, gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës dhe verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore të saj, në përputhje me pikën 3, të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "LDI"), pikës 2 të nenit 44 të Kodit të Procedurave Administrative sipas të cilit "Organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimimi...", si dhe gjermës "b" të nenit 65 të Kodit të Procedurave Administrative, i cili parashikon se: "Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme..."

..b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative”, nuk keni verifikuar statusin juridik të subjektit ndaj të cilit kërkohet fillimi i procedurës administrative, Federata Shqiptare e Taekwondo. Nga dokumentacioni përkatës, rezulton e vërtetuar se Federata Shqiptare e Taekwondo, është shoqatë jofitimprurëse dhe nuk ka asnjë anëtar të saj, që të jetë autoritet publik. Objekti i ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” është garantimi i njohjes së publikut me informacion, që prodhohet ose mbahet nga ana e autoriteteve publike.

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik, nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Sa i përket pretendimit të Autoritetit Publik se, FSHTW zhvillon aktivitetin e saj dhe rregullon marrëdhëniet e saj me antarët e saj dhe palët e treta, konform dhe sipas parashikimeve të Statutit dhe Rregullures së brendshme të saj, Komisioneri vlerëson se këto referenca përforcojnë edhe më tepër qëndrimin se FSHTW është Autoritet Publik. Statuti i Autoritetit Publik në nenin 19 të tij parashikon: “Të ardhurat e FSHTW sigurohen nga Fonde të dhëna nga Buxheti i Shtetit, në formë transferte, të parashikuara në Buxhetin e Shtetit, si dhe burime të tjera të ligjshme. Mënyra e përdorimit të këtij fondi përcaktohet me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit Përgjegjës për Sportin. Ministria Përgjegjëse për Sportin mbikëqyr dhe kontrollon administrimin e transfertës së Buxhetit të Shtetit në të gjitha organizatat sportive që kanë përfituar nga fondet publike etj”.

Për sa më sipër, nisur edhe nga qëllimi dhe objektivat e Autoritetit Publik, vërehet se këtij të fundit i është dhënë e drejta e funksioneve publike nga autoritetet përkatëse, dhe si rrjedhojë, dhënia e informacionit objekt shqyrtimi nuk cenon kurrësi pavarësinë e institucionit, por forcon transparencën dhe përgjegjshmërinë e këtij të fundit.

Theksojmë se, qëndrimi i Komisionerit sa i përket legjitimitimit të Autoritetit Publik bazohet edhe në një rast tjetër të trajtuar më herët me ankesë me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare” ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit. Konkretisht, me shkresën nr. 1935/1 Prot., datë 12.01.2015. Komisioneri në ushtrim të kompetencave ligjore, për të qenë sa më objektiv në vendimmarrjen e tij (në referencë të nenit 24 të LDI) ka kërkuar opinion nga Ministria e Arsimit dhe Sportit nëse statusi ligjor i Federatës Shqiptare të Futbollit është në përputhje me parashikimin e dhënë në shkronjën b), c) të pikës 1 të nenit 2 të LDI.

Në përgjigje të shkresës së dërguar nga Komisioneri mbi opinionin, nëse Federata Shqiptare e Futbollit është pjesë e përcaktimeve të ligjit 119/2014, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka informuar si më poshtë vijon: “Bazuar në Ligjin nr. 9376, datë 21.04.2015 "Për Sportin Federatat Shqiptare të Sportit janë persona juridik, organizata sportive, të cilat veprojnë në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 8789 datë 27.05 2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse" të cilat kryejnë një mision publik të deleguar nga shteti për zhvillimin dhe organizimin e veprimtarive sportive. Për sa më sipër, Federatat Shqiptare të Sportit, sikurse dhe Federata Shqiptare e Futbollit janë ente publike dhe kanë detyrimin ligjor në përputhje me parashikimin e dhënë në nenin 2 pika l shkronja b/c) të ligjit nr.119/2014 Për të Drejtën e Informimit”.


Në vijim, Komisioneri përmes vendimmarrjes së publikuar në faqen zyrtare, konkretisht në lidhjen www.idp.al/wpcontent/uploads/2016/11/vendim_16_fshf.pdf, ka vendosur urdhërimin e Autoritetit Publik/Federata Shqiptare e Futbollit për vënien në dispozicion të dokumentit të kërkuar ankuesit.

Në analizë të parashikimeve ligjore, FSHTW edhe pse gëzon statusin e organizatës jofitimprurëse, pavarësi drejtuese, administrative dhe teknike, është person juridik, i cili ushtron funksione publike dhe nuk përjashtohet si subjekt i ligjit nr.119/2014. Për rrjedhojë, detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës dhe llogaridhënies.

Për më tepër që ankuesi është anëtar i Autoritetit Publik dhe dhënia e dokumentacionit të kërkuar, parashikohet edhe në Statutin e Autoritetit Publik në pikën 11 të nenit 4 dhe në shkronjën c) të pikës 1, të nenit 5, të cilat përcaktojnë në thelb bërjen publike të informacionit objekt shqyrtimi, duke shprehur konkretisht se: “Anëtarët e FSHT-W kanë të drejtë të marrin dijeni për të gjithë vendimet dhe veprimtaritë sportive të FSHT-W”.

Në përfundim Zyra e Komisionerit vendosi, urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP www.idp.al.



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**

**INFORMATION AND
DATA PROTECTION
COMMISSIONER**

Standardet e KiE për të drejtën e informimit

Me temë “E drejta për informim për dokumentet zyrtare, standardet e Këshillit të Evropës (KiE) – The right to access State-held information, Council of Europe standards”, u mbajt në Poloni takimi për shkëmbimin e praktikave të mira në këtë fushë.

Paneli i ekspertëve përbehej nga përfaqësues të Sekretarit të Konventës së Tromsø, Anëtarë të Grupit Akses Info të Këshillit të Evropës (një nga dy organet monitoruese të krijuara nga Konventa e Tromsø sipas nenit 11 të saj, i cili është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Konventës nga palët), përfaqësues të Regjistrisë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe përfaqësuesi i Zyrës së Komisionerit. Ekspertët ndanë përvojën e tyre në lidhje me zbatimin e Konventës së Tromsø si dhe u njohën me rolin e rrjetit të ICIC.



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mori pjesë në këtë aktivitet si përfaqësuese e Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit dhe Komitetit të saj Ekzekutiv (ICIC), për të prezantuar përvojën në zbatimin e standardeve të Konventës “Për aksesin në dokumentet zyrtare”, e njohur ndryshe si Konventa e Tromsø (205) e KiE. Një çështje tjetër me rëndësi që u diskutua në aktivitet ishte dhe veprimtaria në kuadër të bashkëpunimit dy dhe shumë-palësh për nxitjen e adoptimit të këtyre standardeve bashkëkohore jo vetëm në hapësirën gjeografike të Këshillit të Evropës, por edhe më gjerë.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit prezantoi dhe njohu pjesëmarrësit me rolin dhe objektivat e organizatës ICIC për promovimin e të drejtës për informim dhe transparencën e autoriteteve publike kudo në botë. Puna e realizuar nga grupet e punës së ICIC dhe objektivat strategjike të organizatës, si edhe iniciativat bashkëpunuese të ICIC me partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë, iu bënë me dije pjesëmarrësve.

Ky aktivitet u mbajt në kuadër të Konferencës për të Drejtat e Njeriut të Varshavës 2023 (Human Dimension Conference) të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

Garantimi i të drejtave të qytetarëve, takime në Bashkinë Kavajë.

Projekti i përbashkët i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Prezencës në Shqipëri të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) për përmbushjen e detyrimeve të legjislacionit në të dy fushat e përgjegjesisë së institucionit zhvilloi aktivitete në Bashkinë Kavajë.

Në takimin ndërgjegjësues me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të autoriteteve publike të kësaj zone, ishin të pranishëm Komisioneri, z. Besnik Dervishi, Shef i Departamentit të Sundimit të Ligjit në zyrën e OSBE, z. Cailean Maclean, Kryetari i Bashkisë Kavajë, z. Fisnik Qosja dhe përfaqësues të institucioneve qendrore/lokale që e ushtrojnë veprimtarinë në këtë njësi të vetëqeverisjes vendore, si dhe nga bashkitë e Peqinit dhe Belshit.



Në këtë aktivitet trajnues u theksua rëndësia e përmbushjes së detyrimeve ligjore në të dy fushatat e përgjegjesisë së Zyrës së Komisionerit, të cilat ndikojnë në rritjen e transparencës dhe mirëqeverisjes së autoriteteve publike e nga ana tjetër, forcojnë përgjegjshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve për qytetarët.

Në këtë aktivitet u trajtuan elemente të ndryshëm të kuadrit rregullator, ashtu si dhe raste nga veprimtaria monitoruese e mbikëqyrëse e Zyrës së Komisionerit. Vëmendje iu kushtua risive që do të sjellë legjislacioni i ardhshëm kombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale, që transponon tërësisht Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të Bashkimit Evropian (GDPR), ashtu si dhe ndryshimet dhe përmirësimet në ligjin “Për të drejtën e informimit”, që hyjnë në fuqi së shpejti.

Aktiviteti përfshiu edhe komponentët e tjerë për ndërgjegjësimin e qytetarëve, nëpërmjet shpërndarjes së botimeve/fletëpalosjeve nga stafi i Zyrës së Komisionerit, si dhe shkëmbimin e praktikës së mirë në kuadër të transparencës me publikun.

Forcimi i transparencës proaktive për qeverisje të hapur

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka nisur me takimin në Entin Rregullator të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujrave të Ndotura (ERRU) zbatimin e projektit “Transparenca proaktive e institucioneve të pavarura”. Kjo iniciativë ka për qëllim që nëpërmjet komunikimit të hapur dhe të drejtpërdrejtë të nxisë përmirësimin e instrumentit të Programit të Transparencës të këtyre autoriteteve publike, përgjegjshmërinë në funksionimin e tyre dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje.

Gjatë fjalës së tij, Komisioneri, z. Besnik Dervishi, theksoi se qasja e Zyrës është fokusuar te ndërgjegjësimi dhe bashkëpunimi me autoritetet publike, po aq sa edhe te trajnimet e vazhdueshme të stafeve të tyre, për krijimin e kulturës së transparencës dhe qeverisjes së hapur. “Ky projekt është bazuar mbi përvojën pozitive që Zyra e Komisionerit ka nga një iniciativë e ngjashme me organet e vetëqeverisjes vendore. Projekti është i ndërtuar mbi tre komponentë: ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe autoriteteve publike; trajnimin e nëpunësve dhe diskutimin e problematikave; zgjidhjen/trajtimin e rasteve praktike gjatë ushtrimit të funksioneve institucionale”.



Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:



[idp.albania](https://www.instagram.com/idp.albania)



[IDP Albania](https://twitter.com/IDPAlbania)



[Komisioneri KDIMDP](https://www.youtube.com/KomisioneriKDMDP)